




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dep.	Nr. Prot. Dop. Prot. Prot. Nr.
DPKI	06-1932/20
Nr. Titull Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	23.09.2020
P. SHT. E	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.09.2020, mori:


V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. **AKK-DPK-06-1740/20**, për zyrtaren e lartë **znj. Brikena Mulliqi, Anëtare e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK), dhe Drejtoreshë e Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit**, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK- 06-1740/20, e që ka pasur të bëjë me zyrtaren e lartë znj. Brikena Mulliqi, Anëtare e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) njeherit dhe Drejtoreshë e Departamentit për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas pranimit të informacioneve nga një denoncues i jashtëm është kërkuar nga Agjencia për të bërë vlerësimin e situatës së konfliktit të interesit, në lidhje me zyrtaren e lartë znj. Brikena Mulliqi, Anëtare e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) edhe Drejtoreshë e Departamentit për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit(MKRS) sepse konsiderohet se kjo situatë është në papajtueshmeri me nenit 30.4 të Ligjit për Kinematografi.



Pas vlerësimit të këtij informacioni dhe analizimit të situatës, në pajtim me nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit nr.06/L-011, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1766/20, e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj.Brikena Mulliqi, Anëtare e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja i lartë znj.Brikena Mulliqi, ka treguar interesim duke kontaktuar zyrtaret e AKK-së, të cilët sipas procedurës kanë caktuar një takim informues në zyrat e AKK-së. Në këtë takim zyrtarët e AKK-së, e kanë informuar zyrtaren e lartë për arsyen e inicimit të rastit që ka të bëjë me një situatë të papajtueshmërisë që rrjedhë nga nenit 30.4 i Ligjit Nr.2004/22 për Kinematografin, e ku thuhet se: “ Nuk mund të emërohet apo të mbetet Anëtar i Këshillit drejtues Personi: a) që mban a vëhet në post publik të zgjedhur; si dhe për obligimet ligjore që ka zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, duke respektuar parimet e veprimit ku zyrtari ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin dhe kodin përkatës të mirësjelljes.

Gjatë këtij takimi të quajtur ndryshe edhe si, ballafaqim i fakteve, zyrtarja e lartë Brikena Mulliqi, është pajtuar me faktet e prezantuara të Agjencisë, duke thënë se ajo nuk ka pasur njohuri për një kufizim apo papajtueshmëri të tillë duke pas parasysh se ajo ka qenë e deleguar e MKRS, në Këshillin Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) e emëruar me Vendim të ish Ministrisë të Kulturës Rinisë dhe Sportit(MKRS), dhe deri me tash nuk e ka ngritur askush këtë çështje, me gjithë atë në këtë takim znj.Brikena Mulliqi, na ka njoftuar se tashmë, Ministria aktuale e Kulturës Rinisë dhe Sportit(MKRS), ka marr vendim për shfuqizimin e Vendimit për emërimin si anëtare e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK), dhe me vendim të ri të datës 28.08.2020 dhe nr.108/2020, ka emëruar anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) ku znj.Brikena Mulliqi, nuk është më pjesë e këtij këshilli.

Pas vlerësimit të fakteve dhe situatës, kemi ardhur në përfundim se janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik si dhe kufizimit nga nenit 30.4 i Ligjit Nr.2004/22 për Kinematografinë, duke marrë parasysh se Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit(MKRS), me vendim të datës 28.08.2020 dhe nr.108/2020, ka emëruar anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK), andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

